



Informacione për vaksinimin “Covid-19” në vjeshtën e vitit 2022 për shtatzëna

Më të rëndësishmet shkurtimisht

- Vaksinimi përtëritës në vjeshtën e vitit 2022 iu këshillohet fort të gjitha shtatzënave.
- Me vaksinimin përtëritës ju mund të përmirësoni përsëri, të paktën përkohësisht, mbrojtjen tuaj kundër sëmundjeve të rënda.
- Vaksinimi kundër “Covid-19” është i sigurt – edhe në shtatzëni. Ai ju mbron ju dhe fëmijën tuaj.
- Për informacione plotësuese → [Fletëshpjegim «Informacione për vaksinimin “Covid-19”»](#)

Pse jam unë në shtatzëni e rrezikuar në mënyrë të veçantë?

Rreziku për një ecure të rëndë të “Covid-19” tek shtatzënat, për shkaqe të ndryshme, është më i lartë sesa tek femrat e të njëjtës moshe jo shtatzëna. Për shembull, në shtatzëni ndryshon sistemi i imunitetit. Ju mund të jeni në shtatzëni më të ndjeshme ndaj shkaktuesve të sëmundjeve, si për shembull për një infektim me virusin korona. Pasoja e një ecurie të rëndë të sëmundjes mund të jetë që ju duhet të trajtoheni në stacionin e kujdesit intensiv dhe duhet të intuboheni dhe t’ju jepet frymëmarrje.

Përveç kësaj, nëse keni një sëmundje të rëndë korone gjatë shtatzënisë, ju keni një rrezik më të lartë për të pasur një lindje të parakohshme. Kjo mund të ketë si pasojë që për fëmijën tuaj të duhet të kujdeset në stacionin e kujdesit intensiv për të sapolindurit (neonatologjie).

Pas lindjes nuk jeni më të rrezikuar në mënyrë të veçantë, por një vaksinimi kundër “Covid-19” këshillohet po ashtu gjatë dhënies së gjirit. Nën atë gjidhënese të vaksinuar i transmetojnë foshnjës përmes qumështit të gjirit antitropa mbrojtës kundër “Covid-19”.

Si mbron vaksinimi?

Vaksinimi ju mbron ju dhe fëmijën tuaj.

Antitruapat, të cilët formohen tek ju nëpërmjet vaksinimit mund të mbrojnë edhe foshnjën.

Kur duhet të bëhet vaksinimi përtëritës?

Ne ju këshillojmë vaksinimin nga java e 12-të e shtatzënisë (d.m.th. nga tremujori i 2-të i shtatzënisë). Por ai është parimisht i mundshëm edhe më herët në shtatzëni.

Edhe nëse ju planifikoni një shtatzëni, ne ju këshillojmë vaksinimin kundër “Covid-19”.

Vaksinimi mund të bëhet nga 4 muaj pas vaksinimit të fundit kundër “Covid-19” respektivisht nga 4 muaj pas një infeksioni të njohur me virusin korona.

Vaksinime të tjera me lëndë të tjera të çaktivizuara të vaksinimit (si p.sh. vaksina kundër gripit) mund të bëhen para, në të njëjtën kohë me një vaksinim “Covid-19” ose pas kësaj.

Cila lëndë vaksinimi këshillohet?

Shtatzënave, për një vaksinim në vjeshtën e vitit 2022, ne iu këshillojmë një vaksinim me një lëndë mRNA vaksinimi (Pfizer/BioNTech ose Moderna), me përparësi me një variant të përshtatur (bivalent) me një lëndë mRNA vaksinimi, nëse kjo është e disponueshme. Kjo vlen në mënyrë analoge për persona gjidhënës. Edhe lëndët e deritanishme (monovalente) të vaksinimit janë të përshtatshme. Të dhëna aktuale tregojnë se lëndët mRNA të vaksinimit të përdorura deri tani vazhdojnë edhe më tej të mbrojnë mirë kundër varianteve të reja të Omikron-in me ecure të rënda me shtrime në spital.

Çfarë vlen, nëse unë deri tani nuk jam vaksinuar ende kundër “Covid-19”?

Të gjitha shtatzënave, të cilat në vjeshtën e vitit 2022 janë ende të pa vaksinuar u këshillohet vaksinimi i “Covid-19” me dy doza në një distancë prej 4 javësh.¹

Si mund të mbrohem unë si shtesë?

Edhe persona që jetojnë në të njëjtën ekonomi shtëpiake me shtatzënat mund të lenë të vaksinohen. Rreziku i një sëmundjeje të rëndë për persona të shëndetshëm, të vaksinuar, nën moshën 65 vjeç është shumë i ulët falë mbrojtjes tanimë ekzistuese. Vaksinimi ju sjell një mbrojtje të ulët dhe afatshkurtër kundër infeksioneve me sëmundje të lehtë. Në rast të varianteve aktuale të virusit bartja e virusit mbi persona të tjerë pothuajse nuk mund të pengohet me vaksinimin.

Me masa të mëtejshme (p.sh. mbajtja e maskës në hapësirat e brendshme) ju mund të mbroheni në mënyrë shtesë nga një infektim me virusin korona. Orientohuni gjatë kësaj në parimet tona bazë

→ [Faqja e internetit «Kështu mbrohem ne»](#).

¹ Për persona nën moshën 30 vjeç kryesisht me lëndën e vaksinimit Pfizer/BioNTech.

Çfarë është përveç kësaj e rëndësishme?

Në rast pyetjesh për mbrojtjen e nënës në vendin e punës këshillohuni, ju lutemi, në dokumentet e "SECO".

→ www.seco.admin.ch/mutterschutz

Informacione të mëtejshme

Kostot: Një vaksinim i këshilluar kundër "Covid-19" është pa pagesë për ju.

Mundësi të vaksinimit: Informohuni në faqen e uebit ose në linjën e informimit të kantonit tuaj (www.foph-coronavirus.ch/cantons), se ku mund të lini ju të vaksinoheni.

Informacione të mëtejshme mbi vaksinimin kundër "COVID-19" ju mund të gjeni në faqen e internetit të FOPH: www.foph-coronavirus.ch/vaccination ose pyesni mjekun ose mjekun tuaj. Ose në farmacinë tuaj.

Linke:

→ [How does the COVID-19 vaccination work? | FOPH \(foph-coronavirus.ch\)](#)

→ [Frequently Asked Questions \(FAQs\) \(admin.ch\)](#)

